

Prezantimi i librit "Carmen Hernández. Shënime biografike"
Bazilika Shën Pali jashtë Mureve, Romë — E hënë, 29 nëntor 2021

Prezantimi i librit: "Carmen Hernández. Shënime biografike". Transmetuar on-line drejtpërdrejtë në të gjithë botën.

PREZANTIMI I LIBRIT: "SHËNIME BIOGRAFIKE - CARMEN HERNÁNDEZ"

Marrin pjesë në prezantim:

Carlos Metola — Postulator i fazës dioqezane të Çështjes së Lumturimit dhe Shenjtërimit të Carmen Hernández

Prof. Dr. Aquilino Cayuela — Autor i librit

Don Simone Bruno — Drejtor Editorial San Paolo Edizioni (shtëpia botuese e librit)

Kardinal Christoph Schönborn — Arqipeshkëv i Vjenës, Austri

Dr. Kiko Argüello — Nismëtar i Ecjes Neokatekumenale

Don Mario Pezzi — Anëtar i Ekipit ndërkombëtar të Ecjes Neokatekumenale

Maria Ascensión Romero — Anëtare e Ekipit ndërkombëtar të Ecjes Neokatekumenale

Lutja fillestare

KIKO:

Mirëmbërma të gjithëve. Le të lutemi.

Të bekojmë ty, O Ati ynë, Hyj i lavdisë së pamasa për dashurinë që ke me ne, për këtë takim. Ndihmona ti, o Atë, eia mes nesh. Na dhuro Shpirtin tënd të Shenjtë, që t'i japë dëshmi shpirtit tonë për praninë tënde. Për dashurinë tënde dhe për vullnetin tënd, që ne të mund ta bëjmë për lavdinë tënde më të madhe. Për Krishtin, Zotin tonë. Amen.

Këngë: Thirrje Shpirtit Shenjtë. (e kënduar)

DON EZECHIELE PASOTTI:

Mirë. Mirëmbërma të gjithëve dhe mirë se vini në këtë takim për paraqitjen e botimit italian të Biografisë së Carmen Hernández. Detyra ime është të paraqes pak tryezën e kryesisë. Jemi të lidhur me Vjenën, me arqipeshkvin e Vjenës, kardinalin Schönborn, i cili duhet të ishte këtu i pranishëm, ja, por për shkak të izolimit nuk mund të vinte, por është i bashkuar me ne dhe do të bëjë ai më pas paraqitjen e librit të Carmen-it.

Kemi, pastaj, i njihni, ka pak për t'i prezantuar: Kiko Argüello, Ascensión dhe at Mario, ekipi ndërkombëtar i Ecjes Neokatekumenale. Kemi autorin e librit, doktorin Aquilino Cayuela, i cili do të na thotë diçka edhe ai shkurtimisht mbi librin. Kemi Carlos Metola, i cili është i ngarkuari për Çështjen dioqezane të Lumturimit dhe Shenjtërimit të Carmen-it, i cili do të na thotë pak arsyen e këtij libri. Jemi në pritje të don Simone Bruno-s, i cili është përgjegjësi i Edizioni Paoline, që ishte i bindur se takimi fillonte në orën 07:30, por po vjen edhe ai. Unë jam don Ezechiele Pasotti, jam një

meshtar itinerant i dioqezës së Romës, bashkëpunëtor i ekipit ndërkombëtar dhe ai që është kujdesur bashkë me don Francesco Giosuè Voltaggio për botimin italian të librit.

Nderojnë Carmen Hernández-in dhe ne të gjithë, këtë mbrëmje, me praninë e tyre Shkëlqesia e Tij kardinali Robert Sarah, ipeshkëv emerit i Kongregatës për Kultin Hyjnor dhe Disiplinën e Sakramenteve. Një duartrokitje. Shkëlqesi, nëse ngriheni në këmbë, që t'ju shohim. Pranë tij, Shkëlqesia e Tij Imzot Juan Ignacio Arrieta, sekretar i Këshillit Papnor për Tekstet Ligjvënëse, i cili na ka ndihmuar në një mënyrë vërtet të madhe në përgatitjen e Statuteve, dhe është gjithashtu shkëlqesia e tij Imzot Giampietro dal Toso, kryetar i Veprave Papnore Misionare dhe zëvendëssekretar i Kongregatës për Ungjillëzimin e Popujve.

Na shoqëron gjithashtu Dr. Linda Ghisoni, nënsekretare e Dikasterit për Laikët, Familjen dhe Jetën, me bashkëshortin e saj. Kongregata ka dashur të jetë e pranishme seriozisht këtë mbrëmje mes nesh: është gjithashtu don Giovanni Buontempo, zonja Francesca Acito dhe zonja Tania D'Alessandro që po ashtu na shoqërojnë në këtë takim.

Përshëndesim pastaj në mënyrë shumë përzemërt edhe orkestrën e Ecjes Neokatekumenale, me drejtuesin e saj, Tomasz Hanus, i cili do ta përmbyllë takimin duke na bërë të dëgjojmë simfoninë kateketiko-simfonike "Vuajtja e të pafajshmëve", e kompozuar nga Kiko Argüello.

Kemi gjithashtu asamblenë për të paraqitur shkurtimisht disa ekipe itinerante përgjegjëse të Ecjes Neokatekumenale. Nëse ngriheni në këmbë ju përshëndesim me një duartrokitje.

Janë gjithashtu formuesit dhe seminaristët e Seminarit Redemptoris Mater të Romës, nëse ngriheni në këmbë.

Pastaj një përfaqësi e vogël e shumë bashkësive: 400 në Romë, 700 besoj në të gjithë Lacion, që janë këtu këtë mbrëmje për të marrë dhuratën e këtij libri. Nëse ngriheni në këmbë ju bëjmë një duartrokitje. Pastaj janë shumë e shumë vëllezër të lidhur në transmetim të drejtpërdrejtë: bashkësi neokatekumenale të Italisë dhe vendeve të tjera të numërtat që do të ndjekin takimin. Mirë se vini të gjithë.

Para se t'i jap fjalën të parit prej relatorëve, po ju lexoj një shënim të shkurtër të kardinalit Kevin Farrell, Prefekt i Kongregatës për Laikët, Familjen dhe Jetën, i cili i ftuar nuk mundi të ishte i pranishëm, por ka dashur të na dërgojë një përshëndetje:

Të dashur Kiko dhe atë Mario, e nderuar Maria Ascensión:

Kam marrë ftesën tuaj të mirëseardhur për të marrë pjesë në paraqitjen e librit "Carmen Hernández. Shënime biografike", që do të ketë vend më 29 nëntor të ardhshëm pranë Bazilikës së Shën Palit në Romë.

Ju jam mirënjohës për vëmendjen e treguar ndaj meje, por më vjen keq që nuk mund të marr pjesë në veprimtari për shkak të angazhimeve të tjera.

Është dëshira ime që ky botim i rëndësishëm të nxisë një njohje më të thelluar të jetës së Carmen-it, të dashurisë së saj ndaj Krishtit dhe ndaj Kishës dhe të angazhimit të saj të palodhshëm në shpalljen e Ungjillit.

Teksa i siguroj të gjithë për lutjen time, i besohem tuajës dhe ju përshëndes përzemërsisht.

Kard. Kevin Farrell — Prefekt

Ndërhyrje

D. EZECHIELE PASOTTI:

Mirë, atëherë, le ta fillojmë takimin tonë duke ia dhënë menjëherë fjalën relatorit të parë: Carlos Metola, një vëlla i Bashkësisë, i diplomuar në Biokimi në Universitetin Complutense të Madridit, itinerant në Ishujt Kanarie, i cili, siç ju përmenda më parë, është postuluesi i fazës dioqezane të Çështjes së lumturimit dhe shenjtërimit të Carmen Hernández-it. Ai do të na shpjegojë shkurtimisht arsyen e kësaj biografie të Carmen-it. Fjala për ty. Faleminderit.

CARLOS METOLA:

Mirëmbërëma të gjithëve.

Siç e dini, është kërkuar zyrtarisht hapja e Çështjes së lumturimit dhe shenjtërimit të Carmen Hernández-it, bashkënishtetare së bashku me Kiko-n e Ecjes Neokatekumene. Kjo kërkesë u paraqit më 19 korrik të këtij viti 2021 në Madrid, që është dioqeza ku Carmen ndërroi jetë, pasi kishin kaluar tashmë pesë vjet nga vdekja e saj, siç përcaktohet nga normat që rregullojnë këto procese.

Unë, si postulues për fazën dioqezane, gjatë këtyre pesë viteve kam pasur detyrën të përgatis një sërë dokumentesh të domosdoshme për të paraqitur këtë kërkesë zyrtare. Është dashur të mblidhen të gjitha shkrimet e Carmen-it, si edhe të përfundohen transkriptimet e katekezave dhe të ndërhyrjeve të saj në shumë bashkëjetesa, takime e raste të tjera. Ka qenë një punë e jashtëzakonshme, e kryer ndër vite nga motrat dhe vëllezërit që shërbejnë në sekretaritë e Qendrës Neokatekumene në Romë dhe në Madrid. Më pas janë mbledhur të gjithë ditarët e saj — më shumë se shtatëdhjetë ditarë dhe agjenda — si edhe rreth 1600 letra, të shkruara ose të marra nga Carmen së bashku me Kiko-n. Janë mbledhur gjithashtu shumë skica dhe shënime të katekezave, falë punës së një grupi të vogël transkriptuesish dhe korrigjuesish. Në total është dashur të mblidhen rreth 16.000 faqe.

Megjithatë, një kusht thelbësor për të filluar siç duhet një Çështje lumturimi dhe shenjtërimi ishte përgatitja e një biografie të Carmen-it, e dokumentuar mirë dhe me rigorozitet të sigurt historik. Ky është një kusht themelor për

paraqitjen e kërkesës zyrtare për hapjen e Çështjes. Pikërisht për këtë arsye, Zoti zgjodhi profesorin Aquilino Cayuela për të përgatitur këtë libër që sot paraqitet në përkthimin italisht. Edizioni San Paolo e boton këtë vepër në një botim shumë të kujdesshëm dhe të bukur. Ka qenë fryt i një pune të pandërprerë pesëvjeçare kërkimi, studimi dhe përkushtimi nga autori, si edhe nga bashkëpunëtorë të tjerë, veçanërisht don Ezechiele Pasotti, që foli i pari, dhe don Francesco Voltaggio.

Por, a mundet vallë një libër të përmbledhë me të vërtetë jetën, virtytin dhe famën e shenjtërisë së një personi? Të një personi që ka jetuar një jetë kaq intensive si Carmen? A mundet një libër të shpjegojë pesëdhjetë vjet jetë të ungjillëzimit të pandërprerë dhe heroik të Kiko-s dhe Carmen-it, të Carmen-it dhe Kiko-s?

Para së gjithash, çfarë gjenialiteti pati Hyji duke i bashkuar këta dy njerëz! Çfarë urtie kaq e përshtatshme për këto kohë, për të shpallur Ungjillin! Po, Kiko dhe Carmen, Carmen dhe Kiko, me shpalljen e Jezu Krishtit ndërtuan, projektuan një itinerari të Nismës së Krishterë, kaq të domosdoshëm në këtë çast, kaq urgjent për këtë botë, do të thosha thelbësor për kohët tona!

Ky libër, i domosdoshëm dhe i pazëvendësueshëm në një Çështje Lumturimi dhe Shenjtërimi, e bën Carmen-in të flasë. Sepse, në të vërtetë, ndërsa e lexojmë, ne e rijetojmë me Carmen-in një udhëtim magjepsës. Autori e bën Carmen-in të flasë, e bën të pranishme, sepse citon fjalë për fjalë ndërhyrje nga katekezat e saj të shumta. Për ne që e kemi njohur, është sikur të dëgjojmë përsëri zërin e saj.

Dhe, duke zbuluar këtë famë shenjtërie dhe shenjash, lind fillimisht, do të thosha, një ndjenjë kureshtjeje; një pyetje lind spontanisht: «Çfarë do të ndodhë më pas?». Më pas shfaqet edhe një ndjenjë lodhjeje pothuajse fizike: lexuesi lodhet së bashku me Carmen-in. Kur pushonte Carmen në jetën e saj? Po Kiko? Gjatë ditës? Jo! Kurrë! Gjithmonë kishte një veprimtari të pandërprerë. Gjatë natës? As atëherë! Sepse i kushtonte orë të tëra nate lutjes dhe leximit të Shkrimeve të Shenjta, deri vonë natën, për të qenë vetëm me Jezu Krishtin dhe për t'i thënë të Dashurit të saj: «Të dua, të dua shumë, të dua». Ishte një luftë e pamëshirshme.

Përfitoj nga rasti të them se huret dhe nderet e marra me ndërmjetësimin e Carmen-it vazhdojnë të vijnë. Unë marr të gjitha dëshmitë për huret dhe nderet që mbërrijnë nga e gjithë bota. Javën e kaluar arritëm në 1900 hire e ndere nga më shumë se 75 vende. Tani, çdo ditë, gjatë kësaj jave, mbërrijnë katër ose pesë në ditë; ato nga Amerika e Jugut mbërrijnë pak pas mesnate. Por e dimë se shumë njerëz i kërkojnë ndihmë Carmen-it, i kërkojnë favore, dhe përfitoj tani t'ju them juve që i kërkonin favore Carmen-it: shkruani, shkruani në adresën elektronike që kemi dhënë, në mënyrë që dëshmitë të na mbërrijnë. Kjo është shumë e rëndësishme, sepse nevojitet për të dëshmuar famën e shenjtërisë. Adresa elektronike është shumë e thjeshtë: carmenhernandez@ffn.es — carmenhernandez, et, ffn, që do të thotë Fondacioni Famiglia Nazareth, .es, i Spanjës.

E përfundoj duke treguar dy gjëra.

E para. Carmen, që në fëmijëri, siç e dini të gjithë, dëshironte me gjithë zemër të bëhej misionare në Lindje. Që e vogël thoshte se donte të shkonte në Indi, në Lindje. Më pas, kur ajo derë u mbyll, mendoi të shkonte në Perëndim, në Amerikë, në Bolivi, në Oruro, mes minatorëve të minierave. Më vonë shkoi edhe në Tokën e Shenjtë, në Lindjen e Mesme. Por shikoni sa bujar është Zoti: Carmen nuk ishte vetëm në Lindje dhe në Perëndim; ungjillëzimi i saj, së bashku me Kiko-n, u bë universal, mbarëbotëror, katolik, në të gjithë botën. Kaq bujar është Zoti edhe me ne.

Dhe gjëja e dytë që dua t'ju tregoj, ndoshta shumë prej jush e dinë tashmë, por ndoshta të tjerë jo, është dashuria që Carmen kishte për librat. Sot jemi në paraqitjen e një libri. Carmen kishte një dashuri të jashtëzakonshme për librat. Katër bibliotekat e saj përmbajnë më shumë se 4500 libra, të shpërndarë në katër vende të ndryshme. Të gjithë këta libra tashmë janë regjistruar. Shumë prej tyre janë botime të Edizioni Paoline. Ajo që dua t'ju tregoj është se, gjatë udhëtimeve të saj, Carmen zakonisht merrte me vete dy valixhe ose një valixhe dhe një çantë. Në çantë ose në valixhen e vogël mbante sendet e saj personale; ndërsa valixhja tjetër ishte valixhja e librave, e mbushur me shumë libra që i lexonte njëkohësisht. Shpeshherë ne, që ishim në bashkëjetesa me ta, e ndihmonim të mbante valixhet; dhe i mjeri ai që duhej të mbante valixhen e librave! Sepse duhej të transportonte një valixhe vërtet të rëndë. Carmen nuk lexonte vetëm një ose dy libra në të njëjtën kohë; jo, jo, lexonte shumë libra njëherësh. Por Biblën e saj në spanjisht dhe Psalterin e saj në italisht i mbante gjithmonë në çantën e dorës, sepse i lexonte vazhdimisht.

Prandaj e përfundoj duke thënë:

«Faleminderit, o Zot, që më lejove ta njoh Carmen-in, dhe faleminderit, Carmen, që më lejove ta njoh më thellë Hyjin përmes teje!»

Faleminderit shumë!

D. EZECHIELE PASOTTI:

Faleminderit, Carlos. Tani do të dëgjojmë ndërhyrjen e doktor Aquilino Cayuela, edhe ai një vëlla i Ecjes Neokatekumenale, doktor në Filozofi dhe në Shkenca të Komunikimit, i licencuar në Teologji, profesor i Filozofisë Morale dhe Politike, me familje në mision në Berlin dhe autor i këtij libri. Fjala për ty.

AQUILINO CAYUELA:

Jam i martuar dhe kam katër fëmijë; këtu është edhe bashkëshortja ime. Faleminderit shumë.

Shumë të nderuar dhe fort të nderuar kardinalë, Shkëlqesi të nderuara, Ekipi Ndërkombëtar i Ecjes Neokatekumenale, vëllezër dhe motra të dashur: gjëja e parë që duhet të them është se rëndësia kryesore e këtij libri që po paraqesim sot nuk qëndron, si në raste të tjera, tek autori, tek botuesi apo tek konteksti kulturor, por tek personi për të cilin është shkruar kjo biografi: Carmen Hernández Barrera, e cila ishte një grua e jashtëzakonshme, që jetoi me gjithë shpirtin e saj një dashuri shumë të thellë për Krishtin. Ajo ishte një misionare e guximshme, thirrja e së cilës për t'i shërbyer Kishës u bë konkrete kur, së bashku me Kiko Argüello-n, nisën një itinerar të nismës së krishterë, që është Ecja Neokatekumenale.

Së dyti, është shumë e rëndësishme të theksoj se ka qenë një nder i madh për mua që m'u besua kjo detyrë, me nismën e Kiko Argüello-s, dhe në të cilën kam pasur gjithmonë mbështetjen e Ekipit Ndërkombëtar të Ecjes: Kiko, at Mario dhe gjithashtu Ascensión Romero, pa miratimin dhe bashkëpunimin e të cilëve kjo punë nuk do të kishte marrë vlerën dhe qëndrueshmërinë që ka sot.

E kujtoj me shumë emocion mënyrën se si m'u kërkua ta filloja këtë punë, me kërkesën e Kiko-s: «Do të ishte një libër i rrjedhshëm, që do ta bënte të gjallë figurën e Carmen-it dhe që, njëkohësisht, do të kishte vlerën dokumentare të mbledhjes së përvojave, dëshmimeve e materialeve të tjera, në mënyrë që të mos humbnin tani që kujtimi i saj është ende kaq i gjallë. Do të ishte një homazh dhe, në të njëjtën kohë, një shërbim kishtar, si një vepër kujtese për Carmen-in, e cila jetoi kaq pranë Zotit.»

Kam pasur mundësinë të konsultoj dhe të verifikoj hollësitë e kërkimit biografik mbi Carmen-in, si edhe fillimet dhe zhvillimin e Ecjes Neokatekumenale, me vetë Kiko-n, bashkënishtarin dhe themeluesin së bashku me Carmen-in, si edhe me at Mario Pezzi-n, i cili i ka shoqëruar gjatë këtyre pesëdhjetë viteve. Nuk mund të jem më mirënjohës ndaj Zotit dhe ndaj Ekipit Ndërkombëtar të Ecjes për besimin që më kanë dhënë dhe për vëmendjen e kujdesshme me të cilën kanë ndjekur punën time, ndërsa kërkimi dhe shkrimi i tekstit përparonin.

Ky libër hyn, me shumë respekt dhe kujdes, në personin e Carmen-it, për t'i ofruar lexuesit një rindërtim të plotë dhe kronologjik të jetës së saj, duke u mbështetur para së gjithash në dëshminë që ajo vetë na ka lënë. Ai i vendos hap pas hapi në kontekst etapat kryesore të jetës së saj, duke respektuar gjithmonë dëshmitë e saj personale dhe fjalët e saj, si ato të shprehura në rrethana intime e private, ashtu edhe ato të thëna në ngjarje kishtare dhe publike.

Duke hyrë më thellë në tekst, duhet të them se çdo biografi nënkupton hyrjen në brendësinë e personit për të cilin shkruhet, hyrjen në shpirtin e tij, në ndjenjat, dhimbjet dhe gëzimet e tij, në fitoret dhe luftërat e tij, në virtytet dhe vështirësitë e tij; do të thotë të njohësh mendimet dhe synimet e tij dhe, në këtë rast, intimitetin e saj të thellë me Jezu Krishtin, Zotin. Do të thotë gjithashtu të lidhësh atë që është më e dukshme — misionin e saj si katekiste dhe bashkënishtare e Ecjes Neokatekumenale — me këtë botë të veçantë të brendshme, me përvojën e jetuar, për të zbuluar personalitetin më autentik të një gruaje si Carmen Hernández: një grua me nismë të madhe, me shpirt të fortë ripërtëritjeje, me përshpirtëri të thellë dhe jetë lutjeje, e guximshme dhe me një thirrje të palëkundur për t'i shërbyer Jezu Krishtit dhe Kishës; një misionare për ekselencë dhe ungjillëzuese deri në frymën e fundit.

Ishte e rëndësishme të realizohej një punë dokumentare me rigorozitet, duke shmangur rrezikun që libri të bëhej i ftohtë dhe i largët për lexuesin. Përkundrazi, jam përpjekur ta paraqes Carmen-in sa më besnikërisht të ishte e mundur. Pikërisht në këtë pikë, vetë jeta e saj më ndihmoi shumë, sepse rrugëtimi i saj personal, vërtet intensiv dhe dinamik, përshkon historinë e Kishës që nga koha e përgatitjes së Konkilit II të Vatikanit e deri në ditët tona. Ajo ishte një grua e zhytur në Koncil, që nga vitet e formimit dhe përgatitjes për misionin që Hyji i kërkonte, e deri në ditët e fundit para vdekjes së saj. Për këtë arsye kam pasur kujdes të veçantë për të vendosur në kontekst periudhat e ndryshme historike, gjë që shpresoj të jetë me interes për lexuesit.

Libri është i ndërtuar në dy pjesë.

Pjesa e parë, me titull «Pëlhura e zbehtë e orëve të tyre», rindërton në mënyrë kronologjike historinë e saj, nga lindja deri në vitin 1964: fëmijërinë, jetën familjare, çastet e para të thirrjes së saj rregulltare dhe misionare që në fëmijëri në Tudela; më pas vitet e studimeve në Madrid, formimin e saj shpirtëror, rritjen e kësaj thirrjeje misionare gjatë viteve universitare; po kështu hyrjen në jetën rregulltare dhe të gjitha vitet e përgatitjes me Misionaret e Krishtit Jezus, deri në largimin e saj nga ky institut në Barcelonë, në gusht të vitit 1962. Më pas vazhdon me udhëtimin e saj të parë në Izrael në vitin 1963 dhe kthimin në Madrid në vitin 1964, kur takon Kiko Argüello-n.

Pjesa e dytë, «Para meje hapen të gjitha udhët», rindërton historinë e Carmen-it si bashkënishtare dhe përgjegjëse ndërkombëtare e Ecjes Neokatekumenale së bashku me Kiko-n: takimet e para me Kiko-n e ri në vitin 1964, fillimet e këtij itinerari të nismës së krishterë mes të varfërve të Palomeras Altas dhe më pas në disa famulli të Madridit, Zamorës dhe Ávilës, deri në vitin 1968. Libri tregon se si dhe pse shkuan në Romë dhe përshkruan ditët e para të misionit të Kiko-s dhe Carmen-it mes Spanjës dhe Italisë. Në këtë pjesë, ndonëse ruhet rendi kronologjik, mbizotërojnë aspektet tematike që lidhen me zhvillimin dhe përhapjen e Ecjes Neokatekumenale.

Carmen Hernández Barrera, si bashkënistmëtare e Ecjes, dha një kontribut thelbësor në organizimin, formimin dhe përhapjen e saj në mbarë botën. Jeta e saj është një dëshmi e vërtetë e krishterë për mbarë Kishën: fryt i një dashurie intime, të vërtetë dhe të thellë për Jezun Krishtin, thellësisht prekëse për çdo besimtar, ashtu siç ka qenë edhe për mua gjatë gjithë kësaj periudhe pune.

Ripërtërij falënderimet e mia ndaj Ekipit Ndërkombëtar të Ecjes; ndaj Carlos Metola-s, postulues i Çështjes; ndaj përkthyesve, at Ezechiele Pasotti-t dhe Francesco Giosuè Voltaggio-s, edhe për kujdesin me të cilin është përgatitur ky botim i mrekullueshëm në italisht. Gjithashtu falënderoj atë Pasotti-n dhe Imzot Secondo Tejado-n për materialet grafike që shoqërojnë tekstin, si edhe vëllezërit që kanë bërë një punë të madhe dokumentimi në Qendrat Neokatekumenale të Madridit dhe Romës. Një falënderim i veçantë shkon për bashkëshorten time dhe fëmijët e mi, që kanë duruar mungesat dhe udhëtimet e mia të vazhdueshme gjatë kësaj kohe kërkimi. Dhe mbi të gjitha falënderoj Carmen Hernández-in për dashurinë e saj ndaj Jezut Krishtit dhe ndaj Kishës.

Faleminderit shumë.

D. EZECHIELE PASOTTI:

Tani ia japim fjalën don Simone Bruno-s, drejtor editorial i Edizioni San Paolo, shtëpia botuese e këtij libri, si edhe drejtor i sektorit editorial për moshën parashkollore dhe fëmijërinë. Ai shoqërohet nga don Giacomo Perego, i cili ndodhet diku këtu në sallë, biblist dhe përgjegjës editorial i seksionit të Biblës në Edizioni Paoline. Do të jetë interesante të dëgjojmë se edhe për ta, si Shoqëria e Shën Palit, prania sot këtu, në Bazilikën e Shën Palit, ka një domethënie krejt të veçantë.

Fjala për ju, don Simone.

D. SIMONE BRUNO:

Mirëmbërma. Mirë se ju gjeta të gjithëve.

Një përshëndetje shumë të përzemërt për Kiko-n, për miqtë dhe mikeshat e Ecjes Neokatekumenale, si edhe për të gjithë të ftuarit e pranishëm.

Sonte, në cilësinë time si drejtor editorial, i ardhur nga Milano për këtë paraqitje të bukur të librit «Carmen Hernández. Shënime biografike» të Aquilino Cayuela-s, nuk mund ta fsheh emocionin tim. Siç e përmendi më parë atë Ezechiele, e gjej veten pranë secilit prej jush dhe pranë varrit të Shën Palit, në këtë Bazilikë madhështore, vetëm pak ditë pas pesëdhjetëvjetorit të vdekjes së të Lumit don Giacomo Alberione, që ndodhi më 26 nëntor 1971.

Falënderoj Zotin për këtë rrethanë kaq të lumtur, e cila më jep mundësinë të pohoj edhe një herë se sa aktual mbetet vizioni karizmatik i don Giacomo-s tonë. Ai, ndër të tjera, e ka treguar Shën Palin si atin e vërtetë themelues të Paulinëve. Ky vizion na vendos pikërisht në shërbim të ungjillëzimit për mbarë Kishën. Pikërisht për këtë shërbim, drejtuar Popullit të Hyjit dhe gjithë Kishës, jemi mbledhur sonje këtu duke kujtuar figurën e madhe të Carmen

Hernández-it: një grua e dashuruar me Krishtin, me Shkrimet e Shenjta dhe me Eukaristinë, siç na kujton Kiko; një grua e jashtëzakonshme, që e jetoi fenë në shkallë heroike, siç e përsërit Kiko. Me pak fjalë, një «apostulle» e vërtetë e Krishtit, me qëndrueshmërinë dhe stilin e Palit.

Ky vëllim i mrekullueshëm, i shkruar nga profesori Cayuela, që ndodhet këtu pranë meje, më lejoni ta them, dhe jo për ndonjë arsye marketingu të pamenduar — aspak — ky tekst është një thesar i vërtetë. Ai dallohet për rigorozitetin historik dhe për forcën e tij të madhe rrëfimore. Po e përfundoj me një falënderim. Ndiej detyrimin të falënderoj të gjithë Ekipin Ndërkombëtar të Ecjes, që zgjodhi Edizioni San Paolo si botuesin italian për t'i bërë të arritshme për të gjithë «Shënimet biografike të Carmen-it». Dëshiroj të falënderoj edhe ata që kanë ndjekur çdo aspekt të këtij projekti editorial. Më besoni, ka qenë një projekt i ndërlikuar. Falënderoj atë Ezechiele Pasotti-n për ndjekjen e imtësishme të të gjitha fazave; gjatë kësaj periudhe jemi bërë miq të mirë, falë telefonatave të shumta që kemi shkëmbyer.

Dëshiroj gjithashtu të falënderoj at Francesco Voltaggio-n për përkthimin e kujdesshëm dhe të shkëlqyer në gjuhën italiane. Bashkë me të falënderoj edhe dom Giacomo Perego-n, bashkëvëllanë tim, për rileximin, rishikimin dhe redaktimin e tekstit. Së fundi, dëshiroj të falënderoj edhe Agnese Coghe-n, nuk e di nëse është e pranishme këtu, sepse më vonë do të shkoj ta përqafoj, për faqosjen e këtij vëllimi në gjithë origjinalitetin e tij. E them «origjinalitet», dhe me këtë e mbyll, sepse ky tekst të lejon të shijosh njëkohësisht fjalët dhe fotografitë. Kushdo që do ta lexojë do të zhytet në jetën e Carmen-it; do ta dëgjoni dhe do ta shihni, falë edhe aparatit të pasur fotografik që shoqëron kapitujt e ndryshëm.

Carmen është një dhuratë për mbarë Kishën. Si botues, jemi krenarë që mund të kontribuojmë që ajo të njihet më mirë, ashtu siç e meriton. Prandaj, ju uroj një vazhdim të mbarë të këtij prezantimi dhe më lejoni të them: lexim të mbarë të gjithëve. Faleminderit shumë.

D. EZECHIELE PASOTTI:

Dhe tani fjalën ia kalojmë Shkëlqësisë së Tij, Kardinalit Christoph Schönborn, Arqipeshkëv i Vjenës. Nuk do të bëj asnjë prezantim, sepse do të më duheshin dhjetë minuta. Ai na njeh, na shoqëron, është një mik shumë i afërt i yni dhe ka themeluar edhe një Seminari Redemptoris Mater në Vjenë. Shkëlqësi, fjala është për Ju.

MONS. CHRISTOPH SCHÖNBORN:

Faleminderit.

Carmen, më ndihmo! Të paraqes jetën tënde! Jo, nuk jam i aftë! Por të paraqes një libër mbi jetën tënde është më e lehtë.

Por jam edhe i trembur nga vështirësitë e gjuhës: sepse librin e kam lexuar në spanjisht, më pas mora skicat në italisht. Jam i entuziazmuar nga libri i Aquilino Cayuela-s; është bërë shumë mirë, e kam lexuar me shumë entuziazëm.

Ju përshëndes të gjithëve. Ekipin. I dashur Kiko, at Mario, Ascensión dhe ju të gjithë, edhe ata që marrin pjesë përmes internetit në mbarë botën.

Nuk e di pse pata nderin të më kërkohej të paraqisja këtë libër. Do ta bëj me përvujtëri, por me një admirim të madh përballë personalitetit të Carmen-it.

E kam lexuar me shumë interes para së gjithash pjesën e parë, sepse kam mësuar shumë gjëra mbi fëmijërinë, rininë, zhvillimin e saj fetar... edhe mbi Spanjën e fëmijërisë dhe rinisë së saj, Spanjën e pasluftës civile, Spanjën ende shumë katolike, me shumë thirrje meshtarake dhe rregulltare. Pastaj, mbi të gjitha, më ka interesuar shumë epoka e Koncilit II të Vatikanit, që Carmen e ka jetuar me shumë intensitet dhe që për mua është magjepsëse, sepse është edhe koha e rinisë sime rregulltare si domenikan: hyra pikërisht në noviciat në vitin 1963, në kohën kur Carmen shkoi në Tokën e Shenjtë, dhe e përfundova noviciatin kur ajo u largua nga Toka e Shenjtë. Është koha e Koncilit II të Vatikanit. Nëse ka një gjë tepër të rëndësishme në jetën e Carmen-it, në katekezën e saj, është Koncili II i Vatikanit. Nuk ka Ecje Neokatekumenale pa Koncilin II të Vatikanit dhe pa rëndësinë e tij.

Carmen thotë për vitin e saj në Tokën e Shenjtë... po e citoj:

«Hyji më çoi në tokën e Izraelit, të cilën e përshkova pa para, pa asgjë. Nga Libani... deri në Negeb, e deri në Eilat, në Detin e Kuq, dhe atëherë nuk mund të kalohej në Sinai. E përshkova në këmbë gjithë atë tokë dhe Hyji m'i hapi Shkrimet e Shenjta në një mënyrë mahnitëse. E falënderoj Zotin. Dhe unë, mes një mijë vështirësive, shkoja shpesh te shkëmbi i Primatit... Shumë prej jush e njohin shkëmbin e Primatit... Në atë kohë nuk kishte aq shumë turistë; kishte probleme, si edhe sot, muri në Jerusalem ishte ende aty; unë shkoja te Primati i Pjetrit dhe atje kaloja orë e ditë të tëra ulur mbi shkëmb, duke i kërkuar Hyjit cili ishte vendi që kisha unë në Kishë.»

Kam përjetuar shumë takime pas Pashkëve me ipeshkvij, shumë ipeshkvij nga e gjithë bota, së bashku me Kiko-n, Carmen-in dhe At Mario-n, pikërisht pranë këtij shkëmbi të Pjetrit, dhe kam mësuar shumë nga ato kohë të Tokës së Shenjtë në Domus Galilaeae.

Në atë vit 1963/64 unë bëra noviciatin tim në Gjermani. Ishte noviciati i fundit "klasik", para krizës së madhe. Ishim 18 novicë për Gjermaninë dhe Austrinë dhe unë isha 18 vjeç.

Ndërsa po përgatitej kriza e madhe e pas-Koncilit (për të cilën do të flas pak më vonë), në Tokën e Shenjtë po përgatitej një tjetër pas-Koncil: ai i ungjillëzimit, i misionit, i rizbulimit të Pagëzimit si themel i gjithë jetës së krishterë, zbulimi i shqyrtimit të Shkrimeve të Shenjta, i Vigjiljes së Pashkëve, i bashkësive të vogla sipas shëmbëlltyrës së Familjes së Shenjtë të Nazaretit.

Kriza që Carmen përjetoj me bashkësinë e saj rregulltare, "Las Misioneras de Cristo Jesús", më duket si një parandjenjë e krizës gjigante që do të përjetonte Kisha pas Koncilit.

Unë kam jetuar një noviciat "klasik", gjithçka në latinisht, me një ngarkesë të madhe lutjesh në latinisht, të konsideruara jo si gëzim, por si një barrë për t'u mbajtur së bashku, me një disiplinë të rreptë pa u shpjeguar kuptimi i saj. Megjithatë, kam qenë i lumtur në jetën time personale të lutjes, në thirrjen time domenikane.

Por vetëm një vit më vonë filloi cunami i krizës. Më lejoni të them një fjalë, sepse kjo ishte në kontrast me atë që ndodhi më pas me lindjen e Ecjes. Imagjinoni: nga viti 1965 deri në vitin 1980, në 15 vjet, 80.000 meshtarë lanë shërbimin meshtarak... 80.000! Shumica për t'u martuar. Kam parë shumë bashkëvëllezër të lënë jetën rregulltare, meshtarinë. Nuk është aspak meritë e imja që nuk e lashë kuvendin dhe më pas meshtarinë.

Ndërsa kjo krizë fillon të tronditë Kishën, Carmen jeton përvojën e saj në Tokën e Shenjtë: përvojën e një dashurie të thellë për Jezusin, përvojën e lindjes së Kishës. Për Carmen është hiri që mori në Ein Karem, vendi i vizitës së Virgjërës Mari te Elizabeta. Po e citoj:

«Një nga hirit më të mëdha që kam marrë ishte në Ein Karem: unë mendoja të themeloja, me disa shoqe, një shoqatë të re, një lëvizje, por dëgjova Zojën: "Jo... është Kisha: e bekuar je ti ndër gratë, do të jetë Kisha".»

Atje, në Ein Karem, pati vegimin e një shumice të madhe, një populli të veshur me petka të bardha që ungjillëzonte të gjitha kombet.

Kisha NUK është një lëvizje! Një ripërtëritje e Kishës: ky është qëllimi i Koncilit II të Vatikanit.

Por si ndodh kjo ripërtëritje? Ka një element tepër të rëndësishëm në jetën e Carmen-it, të Kiko-s, në lindjen e Ecjes: më lejoni të bëj një lidhje me një përvojë personale.

Pas noviciatit fillova studimet e filozofisë dhe teologjisë te Domenikanët në Gjermani. Teologjia hyri atëherë në një krizë të tmerrshme. Gjithçka u vu në dyshim. Programi i Bultmann-it (protestant, ekzegjet) mbi "çmitizimin" e Biblës: Jezusi, Biri i Hyjit? Gjuhë mitologjike! Mrekullitë? Nuk mund të flitet për to në një botë shkencore! Ringjallja e Jezu Krishtit? "Die Sache Jesu geht weiter!" (çështja e Jezusit vazhdon... por jo vetë Jezusi). Mund ta imagjinoni hutimin në mendjen dhe në zemrën e këtyre domenikanëve të rinj, edhe në mendjen dhe në zemrën time.

Pastaj erdhi revolta e studentëve, lëvizja që u radikalizua, marksizmi si tundim për shumë prej nesh dhe, në Kishë, zgjedhja politike: të ndryshohen strukturat, angazhimi shoqëror, sindikal, politik. Në këtë situatë Zoti më ka, guxoj ta them, shpëtuar mes të varfërve. Një takim me një endacak në derën e kuvendit. Nuk ndalem këtu; dua vetëm të them se si më preku mua, në jetën e Carmen-it dhe më pas të Kiko-s, rëndësia e të varfërve për ecjen e tyre në fe. Jeta e Carmen-it në Tokën e Shenjtë: pa para, pa shtëpi, e varfër mes të varfërve. Pastaj, në Madrid, kjo do të bëhej një realitet shumë konkret, në barakat, duke ndarë jetën me të varfrit. Pa këtë zgjedhje, pa këtë dashuri për të varfrit, pa të varfrit që na mësojnë Ungjillin, nuk do të ekzistonte Ecja me të gjitha bashkësitë e saj.

Carmen e njohu tundimin e politizimit të Ungjillit në atë kohë ndryshimesh. A mjafton të jetosh me të varfrit? A mjafton të jetosh varfërinë vullnetare? A është kjo gjithçka? Dhe çfarë ndryshon kjo në situatën e të varfërve?

Në vitet gjashtëdhjetë-shtatëdhjetë unë e kam njohur këtë tundim. Jo pak bashkëvëllezër të mi shkonin në atë drejtim, disa me një bujari të madhe. Lëvizja e meshtarëve punëtorë, në vitet '50, kishte sigurisht një afërsi me punëtorët, me botën e punës. Në kuvendin tonë të studimeve pranë Parisit, në vitin '68, shumë bashkëvëllezër votonin partinë komuniste.

Ndërkohë hapej një tjetër zbulim, një tjetër takim me botën e të varfërve. Hyji e kishte përgatitur tashmë.

Të dashur miq, ka momente në histori që nuk shpjegohen vetëm si rastësi, edhe pse duken të jenë thjesht rastësi. Shumë prej jush e njihni historinë e Palomeras Altas, të barakave. Ekzistojnë në histori, në historinë e shpëtimit, ngjarje të vogla në dukje rastësore, që, me syrin e fesë, janë plot hir; janë çaste themeluese.

Në fillim të pjesës së dytë të shënimeve biografike mbi Carmen-in, të Aquilino Cayuela-s, gjejmë një ngjarje që do të doja ta citoja me fjalët e Kiko-s. Shumë prej jush e njohin. Unë e kam dëgjuar nga Kiko. Ishte koha kur Garda Civile donte të shkatërronte barakat dhe shkatërroi edhe barakën e Carmen-it. Kiko thotë:

Në atë kohë unë, si përgjegjës i Cursillos, një herë kisha përgatitur një Eukaristi me të gjithë Cursillos e Madridit dhe kisha njohur Imzot Morcillo-n. Atëherë e telefonova, sepse kisha numrin e ipeshkvisë. Përgjigjet sekretari:

«Kush është?».

«Ju lutem, a mund të më kaloni Imzot Morcillo-n? Është çështje jete a vdekjeje». Dhe sekretari më përgjigjet:

«Nuk është e mundur».

Por pikërisht në atë çast kalon Morcillo dhe pyet: «Çfarë po ndodh? Kush është? Kush është?».

«Njëfarë Kiko».

«Ma jep telefonin», thotë Morcillo.

«Atë, vetëm ju mund t'i shpëtoni këta njerëz nga policia!».

Dhe Morcillo më thotë:

«Ku?».

I tregoj adresën dhe Morcillo më përgjigjet:

«Po vij menjëherë!».

Kur i thashë nënkolonelit të Gardës Civile se po vinte Ipeshkvi i Madridit, i cili ishte Këshilltar i Mbretërisë dhe mik i Frankos, ai nuk mund ta besonte; më pa me admirim: «Po si ia doli ky njeri ta sjellë Morcillo-n?». Dhe aty u paraqit Morcillo.

Pastaj Kiko shton:

Për këtë arsye Carmen thotë se, kur e pa Morcillo-n aty, ndryshoi plotësisht qëndrimin e saj ndaj meje.

Shpesh janë gjëra shumë të vogla ato që ndryshojnë historinë! Unë imagjinoj: po të mos kishte kaluar Morcillo pikërisht në atë çast kur Kiko telefoni, përgjigjja "jo" e sekretarit do të kishte mbetur një "jo". Dhe po të mos kishte pasur Morcillo intuitën se duhej të vinte menjëherë... e kështu me radhë.

E shihni, a është e gjitha kjo rastësi? Po, nga këndvështrimi njerëzor. E pikërisht për këtë arsye shumë gjëra janë njerëzisht të pamundura, por për Hyjin asgjë nuk është e pamundur!

Gjëra të vogla që bëhen jashtëzakonisht të rëndësishme për rrjedhën e historisë së shpëtimit. Do të doja t'ju jepja një shembull që më ka prekur shumë në një nga katekezat e Carmen-it. Duhet ta pranoj se shumë herë e kam dëgjuar, por nuk i kam kuptuar mirë katekezat e Carmen-it, sepse nuk e kuptoj mirë spanjishten, flas pak italisht dhe shpejtësia e të folurit të saj, madje edhe "italisht-spanjishtja" e Carmen-it, ishte e vështirë për t'u kuptuar. Por ka një katekeze që nuk e kam harruar kurrë. Ishte një katekeze mbi Jozefin në Egjipt dhe Carmen këmbënguli në një pikë për të cilën unë nuk kisha menduar kurrë. Ajo thoshte se populli hebre u shpëtua falë dëlirësisë së Jozefit. Ju e njihni historinë në Zanafillë. Gruaja e Potifarit ishte përfshirë nga pasioni për Jozefin: «Shtrihu me mua në shtrat!». Por Jozefi nuk pranoi të shtrihej me të për t'u bashkuar me të. Jozefi mbeti besnik urdhërimeve të Hyjit dhe besnik ndaj besimit që Potifari kishte tek ai. Ju e njihni historinë: hakmarrja e gruas, ajo e akuzon Jozefin, ai përfundon në burg, ëndrrat e Faraonit, shpjegimi i ëndrrave, Jozefi bëhet qeveritar i Egjiptit dhe shpëton jo vetëm egjiptianët, por edhe familjen e tij, popullin e ardhshëm të Izraelit. Dëlirësia e Jozefit e shpëtoi Izraelin!

Kjo katekeze ka mbetur në zemrën time dhe ka qenë edhe një pikë kthimi, sepse katekezat kanë pikërisht këtë efekt, shpresojmë! Kjo katekeze e Carmen-it: një thirrje për kthim.

Burri dhe gruaja: kjo katekeze e Carmen-it më preku thellësisht. Ishte konkrete, ekzistenciale, me një thirrje të fuqishme për kthim! Ungjilli është gjithmonë një thirrje për kthim!

Do të doja të ndalesha për një çast, shumë shkurt, te tema e burrit dhe gruas, kaq jetike për jetën njerëzore; të gjithë kemi lindur nga një grua, të gjithë kemi një baba. Dhe kështu do të jetë përgjithmonë; asnjë ideologji (gjinore apo tjetër) nuk mund ta ndryshojë këtë të vërtetë të lashtë.

Marrëdhënia burrë-grua është tema fillestare e Biblës, me gjithë bukurinë që këndon Kënga e Këngëve, dhe me gjithë mjerimet e saj të mëkatit, të dhunës dhe të luftës.

Carmen jetoi tetë vjet në bashkësinë rregulltare të Misionareve të Krishtit Jezus. Pas largimit nga Kongregata, ajo kërkonte një jetë bashkësie dhe misionare me vajza të tjera.

Në vitin në Tokën e Shenjtë, aq vendimtar për jetën dhe thirrjen e saj, ajo u njoh me Atë Paul Gauthier, një takim i rëndësishëm për temën e të varfërve, zgjedhjen për të varfrit, Kishën e të varfërve, një Kishë të varfër... Atë Gauthier-it iu bashkua në Nazaret Marie-Thérèse Lescase dhe së bashku themeluan "Shokët e Jezusit Zdrukthëtar". Ja çfarë na thotë Carmen:

«Atje burrat dhe gratë bashkëpunonin tashmë së bashku. Kur e pashë këtë, m'u duk më mirë se ajo që donim të themelonim ne, vetëm me vajza. M'u duk më e përshtatshme bashkëpunimi me djemtë. Kjo përvojë është, pra, fara e largët e ekipeve të ardhshme itinerante...»

Do të doja të prekja shkurtimisht dy elemente që kanë marrë një rëndësi të madhe në jetën e bashkësive neokatekumenale:

1. Roli, misioni i gruas.
2. Roli i familjeve.

Autori i kësaj biografie të bukur, Aquilino Cayuela, thotë:

Shqetësimi i Carmen-it për vendin e gruas në Kishë lidhet drejtpërdrejt dhe ngushtësisht me veprën që Zoti ka realizuar në të. Ky është pa dyshim kontributi më i veçantë që ajo ka dhënë jo vetëm për katekumenatin e të rriturve që nisi së bashku me Kiko Argüello-n, por edhe për Kishën e sotme. Janë të shumta katekezat drejtuar të rinjve të Ecjes, e veçanërisht vajzave, të cilat shfaqin më mirë anën më personale të Carmen-it.

Dhe do të doja të citoja një fjalë nga një katekeze që shpreh zemrën e këtij vizioni për gruan. Carmen thotë:

«Dhe pse gjarpri, që është simboli dinak i së keqes, e sulmon gjithmonë gruan? E shohim që në faqen e parë të Zanafillës... Dhe pse? Sepse gruaja ka diçka që e bën të madhe, të madhe dhe krijuese, sikur të ishte një shëmbëlltyrë e jashtëzakonshme e fuqisë së Hyjit: krahërorin, mitrën, "fabrikën" e jetës! Dhe kështu vdekja do të kërkojë gjithmonë t'i sjellë vdekjen gruas, sepse, për të shkatërruar planin hyjnor, do të duhet gjithmonë të luftojë kundër gruas.»

Dhe pastaj Carmen, me gjuhën e saj shumë të drejtpërdrejtë dhe ndonjëherë të egër, vazhdon:

“Dhe unë gjithmonë u them atyre: përse më mirë të mos e edukoni burrin që të mos jetë një kafshë? Sepse pikërisht për këtë ai ka inteligjencën, për të zotëruar pasionet e tij; atëherë bëhet më burrë dhe më inteligjent. Prandaj, në vend që ta edukoni gruan të abortojë, edukoni burrin-kafshë që të bëhet më burrë dhe më inteligjent, dhe kështu të gjitha problemet do të zgjidheshin!”

Ka një pikë që ndoshta më lejoni ta them në përfundim, pothuajse në përfundim... që më mungon pak në libër, por mund të shtohet...: Është rëndësia e Humanae Vitae në katekezat e Ecjes.

Që para botimit të Humanae Vitae të Shën Palit VI, bashkësitë e Ecjes, të cilat tashmë kishin lindur, kishin thënë tashmë “po”-në e tyre ndaj mësimi të Humanae Vitae! Frytet janë të dukshme: familjet, familjet në mision në të gjithë botën, seminarët Redemptoris Mater (jemi këtu në seminarin Redemptoris Mater të Vjenës), shumë thirrje për meshtari dhe për jetën monastike... e gjithë kjo është fryt i kësaj “po”-je ndaj “fabrikës së jetës”, ndaj transmetimit të jetës!

Dhe përfundoj përfundimisht me dy fjalë: njëra e Shën Gjon Palit II, e thënë në vitin 2002: *“Pa Carmen-in Ecja nuk do të mund të ekzistonte”*.

Këto shënime biografike na paraqesin rrugëtimin e gjatë të përgatitjes së Carmen-it për misionin e saj.

Dua ta përfundoj me një tjetër fjalë të shkruar nga Imzot Marcellino Olaechea (i cili pati një rëndësi shumë të madhe në jetën e Carmen-it, arqipeshkëv i Valencias), pikërisht 40 vjet para fjalëve të Shën Gjon Palit II për Carmen-in. Ai thotë në një letër të datës 28 prill 1962 drejtuar Carmen-it:

“Ti je e singertë, shumë e singertë, brutalisht e singertë.”

Dhe shton:

Për të gjitha këto, misionarja Carmen Hernández, shumë e çiltërta Carmen Hernández, Carmen Hernández më e çiltërta dhe “e egra”, mund të mendojë se kalon për një murgeshë të matur, të rregullt dhe të zellshme...

Të kesh pak frikë prej teje nuk është e padrejtë. Ti je një tip që mund të bëjë të mendosh gjatë, sepse je disi “e egër”. Të shpresosh tek ti do të ishte shumë e drejtë, sepse je fisnike, shumë fisnike; dhe do të dije të bindeshe (edhe pse me protesta, gjatë viteve të formimit) dhe do të dije të sakrifikoheshe, dhe shpresoj që t’i japësh Zotit një fryt shumë të madh nga dhuratat e mëdha që Zoti ka vendosur në ty.

Të dashur miq, çfarë fjale profetike për Carmen-in! 40 vjet para fjalëve të Shën Gjon Palit II: një fryt shumë i madh nga dhuratat e mëdha që Zoti ka vendosur në ty!

D. EZECHIELE PASOTTI:

Faleminderit, Shkëlqësi, për fjalët tuaja vërtet të çmuara mbi jetën dhe dëshminë e Carmen-it. Dhe tani ia japim fjalën dëshmitarit *par excellence*, atij që për 52 vjet ka jetuar së bashku me Carmen-in dhe që drejton takimin tonë këtë mbrëmje: doktorit Kiko Argüello.

KIKO ARGÜELLO:

Anekdotat e parë që dua të tregoj për Carmen-in: ajo gjithmonë më përçmonte, sepse më konsideronte... nuk them një budalla, por pothuajse. Ajo ishte shumë inteligjente, kishte marrë çmimin e jashtëzakonshëm të karrierës. Por një gjë ma tha, kur pa se arqipeshkvi i Madridit, Këshilltar i Mbretërisë, një njeri shumë i rëndësishëm i epokës së Frankos, shkonte në barakën time, hynte në barakë dhe thoshte: “Unë nuk jam i krishterë, Kiko”. Kështu, kur pa shtratin tim atje, në tokë, etj., kur pa kishën që ishte me mua, Carmen-i ndryshoi rrënjësisht qëndrim ndaj meje; që nga ai moment filloi të bashkëpunonte me mua, seriozisht. Shihet dashuria që ajo kishte për Kishën, për Papën, për Kishën. Mirë, këtu kam shkruar disa fjalë, po i lexoj që të mos zgjatem.

Gjëja e rëndësishme e këtyre SHËNIMEVE BIOGRAFIKE është se shihet që është Zoti ai që vepron në jetën e Carmen-it dhe se Carmen-i është një vepër e Shpirtit të Shenjtë në Kishë. Si Carmen-i ashtu edhe unë kemi qenë dëshmitarë të pranisë së Zotit në ungjillëzim, dëshmitarë të veprimit të Zotit në Kishën e Konkilit II të Vatikanit. Ne nuk kishim plane, as ide të paraformuara... Kemi parë se Zoti ekziston dhe krijon bashkimin, bashkësinë.

Për 50 vjet kemi mundur të japim dëshmi se Zoti është i gjallë në Kishën e tij. Atë që po përpunohej me shkrim në Konkilin II të Vatikanit, e kemi parë të realizohej në Palomeras përmes veprës së Shpirtit të Shenjtë. Atje kemi parë të shfaqej Zoti duke krijuar faljen, dashurinë, bashkësinë, komunitetin e krishterë mes të varfërve!

Zoti ka vepruar në jetën e Carmen-it dhe në timen dhe ka dashur të na bashkojë për një mision. Historia e Ecjes është një seri ngjarjesh në të cilat shohim Zotin që vepron.

Zoti bën një histori të gjatë përgatitjeje me Carmen-in: ndikimi i Shën Françesk Ksavierit në thirrjen e saj misionare, koha e kaluar në Institutin Misionar, studimet e saj të Teologjisë në Valencia... e çojnë atë të përjetojë në mishin e saj gjëra që janë të pabesueshme, si Misteri i Pashkës, i vdekjes dhe i ringjalljes, të cilin ajo e jetoi në Barcelonë gjatë procesit të largimit nga Misionaret e Krishtit Jezus, dhe takimi me At Farnés-in, në çastin më kritik të *kenosis* (zbritjes) së saj, prandaj ajo thoshte se ai ishte engjëlli që Zoti i kishte dërguar në Gjetsemanin e saj. At Farnés-i, dishepull i Don Botte-s, kishte jetuar dhe njohur në Paris liturgjistët më të mirë që kishin përgatitur reformën e Koncilit.

I tregoj këto gjëra për të thënë se si Zoti përdori Carmen-in, dhe mua, për të çuar përpara një vepër që nuk është e jona. Carmen-i, kur u largua nga Kongregata, gjëja e parë që bëri ishte t'i thoshte grupit të shoqeve me të cilat donte të themelonte një kongregatë të re ungjillëzimi: "Unë, duke ndjekur Shën Injacin, shkoj në Tokën e Shenjtë për një vit, me Shkrimet". Ajo gjeti një shoqe irlandeze që e shoqëroi. Dhe me një çantë shpine dhe një tendë kampingu përshkuan të gjithë Izraelin. Ajo thoshte se atje në Izrael, në brigjet e liqenit të Tiberiadit, ulur mbi shkëmbin e Primatit të Pjetrit, i kërkoi Zotit çfarë dëshironte prej saj dhe ndjeu se Zoti i thoshte se do t'ia shfaqte vullnetin e tij në Kishë: dashurinë ndaj Krishtit, të pranishëm në veprimin që duhej të kryente në Kishë; pastaj pa se bëhej fjalë për të hapur me mua këtë Nismë të Krishterë, që është Ecja Neokatekumenale.

Viti i kaluar në pelegrinazh përmes Izraelit ishte për të një udhëtim i paharrueshëm, në të cilin iu hapën Shkrimet në një mënyrë mbresëlënëse, duke kuptuar bashkimin e historisë së shpëtimit me tokën në të cilën Zoti ka dashur të shfaqet. Vizita e Papës Shën Pali VI në Nazaret në janar 1964, ku ajo mundi të ishte e pranishme, e ndihmoi të kuptonte çelësat themelorë të Koncilit, duke parë në kthimin te origjinat e krishtera dhe te rrënjët hebraike shtyllat më të rëndësishme për ripërtëritjen e Kishës.

Njohja e Koncilit dhe e tokës së Izraelit nga ana e Carmen-it janë në origjinën e dashurisë së madhe që lindi në Ecje për Izraelin, popullin e tij dhe traditat e tij, gjë që do të jetë diçka themelore për jetën e saj dhe për zhvillimin e Ecjes.

Zoti më ka udhëhequr, përmes takimit me vuajtjen e të pafajshmëve dhe njohjes së të Lumit Charles de Foucauld, për të jetuar me të varfrit, duke menduar se nëse Zoti do të kthehej, në ardhjen e tij të dytë, do të doja të më gjente në këmbët e Krishtit të kryqëzuar me të fundit e tokës, me të pafajshmit.

Carmen-i dhe unë u njohëm në vitin 1964, pas kthimit të saj nga pelegrinazhi i saj historik në Tokën e Shenjtë. Unë kisha shkuar të jetoja në një barakë me të varfrit në Palomeras Altas. Atje Carmen-i njohu komunitetin e të varfërve që mbledheshin në barakën time dhe mbeti shumë e mahnitur nga përgjigjja që ata i jepnin Fjalës së Zotit. Vendosi të qëndronte të jetonte me ne dhe ne i ndërtuam një barakë pranë asaj ku jetoja unë.

Carmen-i kishte jetuar tashmë në barakat e Barcelonës dhe kishte bërë disa përpjekje për një fondacion të ri. Thirrja e saj ishte misioni, duke ndjekur gjurmët e Shën Françesk Ksavierit, dhe ajo kurrë nuk mendoi të qëndronte në Spanjë, aq më pak në Madrid, ku jetonte familja e saj; për të kjo ishte si një dështim i idealit të saj misionar. Por në Palomeras Zoti deshi që të bashkoheshim kundër çdo parashikimi.

Aty ishte e mundur që Carmen-i të shihte Jezhu Krishtin, i cili vjen për të shpëtuar mëkatarët dhe për të realizuar misterin e Pashkës, për të krijuar bashkësinë, aty ku ishte e pamundur që ajo të realizohej: mes njerëzve të zakonshëm dhe ciganëve. Sepse ne pamë atje dhe prekëm Shpirtin e Shenjtë, që shfaqej duke krijuar një bashkësi që ishte e pamundur mes ciganëve dhe njerëzve të atij lloji.

Carmen-i vinte nga një përvojë me shoqet e saj në Barcelonë, të cilat kishin punuar me punëtorë, duke dhënë jetën e tyre atje, duke pritur pastaj t'u flisnin për Jezhu Krishtin, pas një kohe mishërimi mes tyre; por ai moment nuk vinte kurrë. Megjithatë, Carmen-i pa në barakën time se unë flisja për Jezhu Krishtin dhe se ata dëgjonin; atje pa se si shërbente Jezhu Krishti: dashurinë falas që Zoti ka treguar për shpëtimin e njeriut, për ta çliruar nga skllavëria, ankthi dhe mëkati. Jezhu Krishti bëhej i pranishëm.

Gjithçka që Zoti lejoi, e gjithë prania e tij në Palomeras, ishte si një tokë kultivimi që Zoti e kishte përgatitur për ta sjellë brenda Kishës. Gjithçka që Zoti na bëri të përjetojmë në mes të një bote të varfër, Zoti e kishte përgatitur për Kishën e tij.

Ishte një mrekulli që Imzot Morcillo të vinte në baraka, një mrekulli e pabesueshme: një Këshilltar i Mbretërisë, në epokën e Frankos, që të shfaqej atje i veshur si meshtar në një 600 (makinë Seat 600); që të hynte në barakën time; që të lutej me ne; që të na njihje si të tijtë... KRYEIPESHKVI hyri në barakën time, pa si jetoja, si luteshin vëllezërit dhe tha: "Unë nuk jam i krishterë"! Garda Civile kishte filluar të rrëzonte barakat, duke filluar nga baraka e Carmen-it, por ardhja e arqipeshkvit i ndaloi.

Ishte prania misterioze e Imzot Morcillos në baraka ajo që e bëri Carmen-in të vendoste të bashkëpunonte përfundimisht me mua. Nëse nuk do të kishte qenë për Morcillo-n, ne nuk do të kishim shkuar në famulli! Dhe ishte përsëri ai që na hapi dyert në Itali.

Carmen-i pa tek Imzot Morcillo praninë e Kishës dhe ndryshoi plotësisht qëndrimin e saj ndaj meje; me praninë e Arqipeshkvit, ajo pa të realizohej premtimi që Zoti i kishte bërë në Izrael. Kur Carmen-i ishte në Izrael, pyeste shpesh veten se cili ishte misioni i saj në Kishë dhe mendonte se duhej të themelonte një kongregatë misionare. Në Ain Karen pati sigurinë absolute, si një vegim, se Zoti donte që ajo të bënte diçka për Kishën universale, se nuk bëhej fjalë për të themeluar një kongregatë. Ju tregoj këtë që të shihni se si është një mister i madh i Zotit bashkëpunimi mes Carmen-it dhe meje.

Pas përplasjeve të para që pata me Carmen-in në baraka, shkova të flisja me drejtuesin tim shpirtëror, një domenikan nga kuvendi i Atocha-s dhe, në mënyrë të papritur, më tha: "Dëgjoje këtë grua. Nëse ajo që të thotë të duket e mirë, kthehu dhe bindu asaj; nëse nuk të duket e mirë, mos i kushto vëmendje".

Më kushtoi shumë ta pranoja Carmen-in, derisa Zoti më bëri të ndieja brenda vetes se Carmen ishte një hir i madh për mua, që dikush të më thoshte vazhdimisht të vërtetën: Zoti ma kishte dërguar me një mision; atëherë e pranova Carmen-in në fe, si të dërguarën e Zotit. Vuajta derisa kuptova në fe se ajo vinte nga Zoti dhe që nga ajo ditë ajo ka qenë një hir për mua. Carmen ka qenë e mrekullueshme, mahnitëse!

Rabini Rosenbaum, në letrën e tij të ngushëllimit për vdekjen e Carmen-it, më shkroi: "Carmen ka qenë një 'tsaddiqah', një grua e shenjtë dhe e drejtë, një grua me vizion profetik dhe me një dashuri pa kufij për bijtë e Zotit. Kam pasur privilegjin ta njoh dhe të kem mundur të përjetojmë së bashku 'Ruah haqqodesh', shpirtin e shenjtërisë që ajo e zotëronte në mënyrë unike. Shalom!".

Një dashuri e pakufishme, thotë rabini, për vëllezërit e Ecjes, për të cilën mund të jap dëshmi. Sa orë kemi kaluar duke dëgjuar katekumenët tanë, person për person! Carmen kishte një kujtesë të jashtëzakonshme, kujtonte jetën e të gjithë vëllezërve. Edhe të itinerantëve, të familjeve në mision dhe të meshtarëve! Ajo ia dorëzonte vazhdimisht veten Zotit përballë kaq shumë shqetësimeve dhe pasigurisë së plotë me të cilën dërgonim itinerantët dhe familjet në mision.

Carmen, çfarë gruaje e mrekullueshme! Me një gjenialitet mjeshtëror lirie dhe dashurie për Kishën! Ajo kurrë nuk më ka lajkatur. Gjithmonë më ka thënë të vërtetën! Ishte e aftë të qëndronte pas meje, gjithmonë pranë meje, për të më ndihmuar. Ajo e kishte të qartë se misioni që Zoti i kishte dhënë ishte të më mbështeste, të më mbronte dhe të më korrigjonte, për të mirën e Ecjes Neokatekumenale. Nga dashuria për Kishën dhe për vëllezërit, ajo qëndroi në krahun tim për 50 vjet; edhe pse ndonjëherë kjo ishte e vështirë për të, Carmen-it i interesonte vetëm të bënte vullnetin e Zotit, të cilin ajo e shihte të qëndruarit me mua, në këtë Nismë të Krishterë që është Ecja Neokatekumenale. Një grua e jashtëzakonshme, me të vërtetë, me një bujari të madhe, ajo e mohoi veten për të më nxjerrë mua në pah; pavarësisht korrigjimeve, ajo qëndronte gjithmonë pas meje.

Ky libër do t'ju bëjë të njihni një Carmen të panjohur për shumë njerëz: intimitetin e saj, thirrjen e saj, dashurinë e saj për Krishtin, takimin e saj me mua, fillimet e Ecjes, misionin e saj në Kishë. Do t'ju befasojë. Carmen ishte një mister dhe në këto "Shënime biografike" do të mund të hyni pak në misterin që është Carmen Hernández dhe në misterin e madh që kemi mundur të bashkëpunojmë së bashku për 50 vjet.

Kjo biografi nuk është vetëm për vëllezërit e Ecjes, por është për të gjithë Kishën, për të bërë të njohur një grua të jashtëzakonshme, një profeteshë të vërtetë, një misionare autentike, e cila e ka jetuar fenë e saj në shkallë heroike. Një grua e jashtëzakonshme, shumë e rëndësishme për Kishën; e dashuruar me Krishtin, me Shkrimet dhe me Pashkën, dhe me një dashuri të pakushtëzuar për Papën dhe Kishën.

Së bashku jemi nismëtarët e një karizme, të një mrekullie të Zotit në ndihmë të Kishës së tij: që është Ecja Neokatekumenale. Siç tha Papa Françesku më 5 maj 2018 në Tor Vergata: "Ecja Neokatekumenale është një dhuratë e Shpirtit të Shenjtë për Kishën".

Këtë ka thënë ky Papë: Ecja Neokatekumenale është një dhuratë e Shpirtit të Shenjtë për Kishën, ka thënë Papa Françesku. Janë fjalët e Atit të Shenjtë, të Papës Françesku, i cili është gjallë dhe që është Papa ynë, është Ipeshkvi ynë, që na do. Kemi qenë me të dhe ai na tregonte një dashuri të madhe. Më thotë, fjalët e para që më tha kur më pa: "Kiko, çdo gjë që ti vendos, unë ta miratoj". Këto janë fjalët me të cilat ai më priti. Mirë, shpresojmë të mos vendosim gjëra të çuditshme. Mirë, kemi mbaruar.

D. EZECHIELE PASOTTI:

Faleminderit, Kiko. Tani i takon meshtarit të ekipit, at Mario-s, të japë pak dëshminë e tij.

D. MARIO PEZZI:

Mirë, unë flas si dëshmitar i gjithë këtyre viteve. Së pari falënderoj Zotin që më ka dhënë dhuratën për të jetuar shërbesën meshtarake në ekipin e Kiko-s dhe Carmen-it, pas meshtarëve Jesús Blázquez dhe Francesco Cuppini-t, fillimisht që nga muaji korrik i vitit 1971, kur Kiko dhe Carmen ndodheshin në Itali, dhe që nga viti 1982 me kohë të plotë, deri në kalimin e Carmen-it në Qiell në vitin 2016, dhe me Kiko-n dhe Ascensión-in, deri më sot.

Jam i lumtur që marr pjesë sot në prezantimin e "Shënimeve Biografike" të Carmen Hernández, të Aquilino Cayuela-s. Jam shumë i lumtur që ndodhem në këtë Bazilikë të Shën Palit. Uroj që leximi i këtij teksti të mund të ndihmojë shumë vëllezër të Bashkësive Neokatekumenale, veçanërisht meshtarët, seminaristët, katekistët, itinerantët, motrat dhe familjet në mision, për të njohur më thellë misterin e kësaj karizme, të njohur zyrtarisht nga Papët e fundit si një dhuratë e Zotit për Kishën, dhe rëndësinë e misionit në të cilin na thërret për të jetuar në shoqëri dhe brenda Kishës së sotme.

Do të doja të nënvizoja disa aspekte që më kanë prekur më shumë nga jeta e Carmen-it gjatë këtyre viteve, të përshkruara shumë mirë në libër.

Dhuratat e veçanta dhe disa prej tyre të jashtëzakonshme, si ëndrra e famshme gjatë ushtrimeve shpirtërore para kushteve rregulltare në Institutin e Misionareve të Krishtit Jezus në Javier, të cilën ajo na e ka treguar disa herë: Në këtë ëndërr, ajo përjetoi një zbritje të thellë dhe një vdekje, duke u përpjekur të ndiqte ftesën e Jezu Krishtit që i thoshte: "Ndiqmë", por duke përjetuar se nuk kishte forcë; dhe më pas një ngjitje të shpejtë deri sa u pushtua nga një gëzim i papërshkrueshëm, një shije paraprake e lumturisë së Qiellit. Në Zamora, në vitin 1994, duke folur për këtë përvojë, na tha: "Këtë ëndërr nuk e kam harruar kurrë, as në momentet më të thella të krizës dhe të ankthit në jetën time. Më mbetet një kujtesë shumë e fortë e ndërhyrjes së Zotit në jetën time".

E përmenda këtë ëndërr si çelësin që i mundësoi Carmen-it, e shoqëruar nga liturgjisti at Farnés, të kuptonte në mënyrë ekzistenciale misterin Pashkës, kalimin nga mundimi dhe vdekja në kryq, në gëzimin e ringjalljes, që po realizohej në mishin e saj përmes dëbimit nga Instituti i saj, deri në zbulimin gradual të vendit të saj në Kishë, që do të realizohej në takimin me Kiko Argüello-n, në barakat e Palomeras Altas, në periferinë e Madridit.

Jam mirënjohës ndaj Zotit sepse përmes Carmen-it dhe historisë së saj, konkretisht në pelegrinazhin e saj në Tokën e Shenjtë, Zoti i ka dhuruar Ecjes Neokatekumenale të rizbulojë rrënjët e besimit tonë në popullin e Izraelit, të dëshiruara nga Kushtetuta Dogmatike "Dei Verbum" dhe nga Deklarata "Nostra Aetate" e Konkilit II të Vatikanit.

Ka qenë një gëzim i madh, mendoj për të gjithë ne, dorëzimi i Doktoratës Honoris Causa rabinit David Rosen dhe Kiko Argüello-s, në Universitetin Francisco de Vitoria të Madridit, në 25 tetorin e kaluar. Kiko, në këtë rast, tha: "Një pjesë e madhe e kësaj Honoris Causa i përket Carmen-it", sepse ky takim, sipas mendimit tim, vulosi një rrugëtim të gjatë afrimi dhe miqësie me popullin e Izraelit, falë mbi të gjitha kremtimit javor të Fjalës së Zotit në bashkësitë tona, gjatë itinerarit neokatekumenal me etapa, dhe gjithashtu falë Domus Galilaeae, një tjetër dhuratë për Ecjen falë miqësisë së Carmen-it me françeskanët e Tokës së Shenjtë, në udhëtimin e saj të parë në Tokën e Shenjtë. E projektuar nga Kiko Argüello, Domus Galilaeae, e inauguruar nga Papa Shën Gjon Pali II në Vitin Jubilar 2000, është bërë një destinacion për shumë hebrenj dhe një burim takimesh dhe njohjeje të ndërsjellë. Siç dëshironte letra e fundit e shkruar nga Papa Gjon Pali II, pak ditë para vdekjes së tij, në vitin 2005, dërguar me rastin e inaugurimit të Bibliotekës dhe të takimit me kardinalë dhe hebrenj.

Për më tepër, "Simfonia e të Pafajshmëve", e kompozuar nga Kiko Argüello, e interpretuar për herë të parë në Domus Galilaeae, gjatë një Bashkëjetese për Kardinalë dhe Ipeshkvij të Shteteve të Bashkuara, në praninë e disa rabinëve të Jerusalemit. Duke dëgjuar këtë Simfoni, rabinët e pranishëm u ndjenë të kuptuar në dhimbjen e tyre për Shoah-un (Holokaustin). Me kërkesë të rabinëve, kjo Simfoni u interpretua në Teatrin e Jerusalemit dhe më pas në shumë pjesë të botës, nga New York në Auschwitz, në Tokio, dhe ka kontribuar në rritjen e njohjes dhe miqësisë së ndërsjellë. Për më tepër, dy Bashkëjetesat e Kardinalëve, Ipeshkvijve dhe shumë rabinëve nga e gjithë bota, në Domus Galilaeae, na kanë bërë të përjetojmë praninë e Shpirtit të Shenjtë, në një bashkim të madh dhe në respekt të ndërsjellë.

Një aspekt tjetër, për të cilin ka folur tashmë Kiko, por që mua më ka prekur shumë gjatë gjithë këtyre viteve dhe që dua ta theksoj, është zelli që ka nxitur Carmen-in, për shumë vite, siç tha tani Kiko, për të dëgjuar së bashku me Kiko-n, me rastin e kremtimeve të etapave të ndryshme, çdo vëlla dhe motër të bashkësive të tyre në Spanjë dhe Itali: në Romë, Firence dhe Ivrea, dhe në Paris në Francë, për orë e orë të tëra, me shumë përlësi dhe durim. Duke vlerësuar nivelin kulturor, shumë më të lartë se i imi, si të Carmen-it ashtu edhe të Kiko-s, orë e orë të tëra.

Kujtoj tani atë që përsërit shpesh Papa Françesku, për të "dëgjuar, dëgjuar të varfrit", për të dëgjuar dhimbjet, traumat, kryqet. Ne e kemi bërë këtë për shumë vite dhe është e mrekullueshme që në fund të Ecjes, në etapën e Zgjedhjes, kemi parë se shumë trauma, shumë dhimbje dhe vuajtje të përjetuara ndriçohen përpara Kryqit të lavdishëm të Krishtit dhe vëllezërit zbulojnë në këto vuajtje, në këto padrejtësi, dashurinë e Zotit; për këtë arsye nuk mund të ripërtërihen solemnisht Premtimet e Pagëzimit, pa na ndriçuar kryqi i Krishtit dhe pa na bërë të zbulojmë se edhe përmes vuajtjeve dhe padrejtësive Ai na shfaq Dashurinë e Tij duke na çuar tek Ai. Kjo është një mrekulli që e kemi parë të realizohet në të gjithë botën, falë ekipeve itinerante, në të gjitha kombet dhe në të gjitha kulturat.

Carmen dëgjonte me durim në heshtje përvojën e çdo vëllai deri vonë natën, dhe kur ishte e nevojshme ndërhynte. Në vizitat periodike në çdo bashkësi, pyeste për çdo vëlla dhe motër, duke telefonuar dhe ndihmuar vëllezërit që kishin vështirësi më të mëdha. Vëllezërit e bashkësive tona, këtu të pranishëm ose të lidhur në transmetim on-line, do ta kujtojnë, janë dëshmitarë: orë e orë të ulur duke dëgjuar deri vonë natën.

Mund të flisja për shumë aspekte të tjera të personit të Carmen-it, bashkimin e saj të brendshëm me Zotin, me thirrjen e vazhdueshme të emrit të Jezusit, veçanërisht në momentet e ankthit dhe të vuajtjes fizike, në disa momente, si Nënë Tereza e Kalkutës, Shën Tereza. Ashtu si shenjtërit e mëdhenj, ajo ka kaluar periudha të mosbesimit të madh, të natës së errët, thoshte: "Nuk besoj, nuk besoj më", dhe unë, që isha pranë saj, i thosha: "Carmen, ti je ateistja që lutet më shumë se të gjithë të krishterët". Thoshte se nuk besonte më dhe qëndronte vazhdimisht me Shkrimin dhe duke u lutur. Edhe në momentet e vuajtjes fizike.

Dashuria e saj e madhe për Papën, shkëmbi mbi të cilin Jezu Krishti ka themeluar Kishën e Tij, përkushtimi i saj në bashkëpunimin e frytshëm me Kiko Argüello-n në ungjillëzim; shumë prej këtyre aspekteve dhe shumë të tjera janë paraqitur në këtë libër që sot prezantohet zyrtarisht dhe që ju mund ta lexoni.

E përfundoj duke bekuar përsëri Zotin për dhuratën e Carmen-it dhënë Ejës Neokatekumenele, për Kishën e sotme dhe për jetën time. Faleminderit.

D. EZECHIELE PASOTTI:

Faleminderit, at Mario. Dhe tani, për ta përfunduar, fjala i jepet asaj që Zoti e ka thirrur për të marrë vendin e Carmen-it në ekip dhe në Ecje: Maria Ascensión Romero.

MARIA ASCENSIÓN ROMERO:

Vendin e Carmen-it? E pamundur! Ajo është e papërsëritshme!

Para së gjithash dua ta falënderoj, në emër të ekipit, Aquilino-n për këtë libër, për këtë biografi, e cila do t'i japë shumë lavdi Hyjit dhe do t'u mundësojë shumë njerëzve ta njohin Carmen-in. Por mbi të gjitha dua ta falënderoj Hyjin, i cili e ka ndihmuar shumë Aquilino-n, sepse në këtë biografi shihet se Hyji ka qenë i pranishëm, se e ka udhëhequr dhe e ka ndihmuar.

Që në fillim, që kur Aquilino na paraqiti skicat e para të veprës, më pëlqeu. Më pëlqeu shumë. Më mahniti të takoja këtë Carmen të re, me kaq jetë, kaq të guximshme, kaq të mbushur me jetë dhe entuziazëm për misionin, kaq të dashuruar me Jezu Krishtin dhe me kaq zell për shpalljen e Ungjillit. Ajo forcë jetësore e Carmen Hernández-it në rininë e saj të tërheq gjithnjë e më shumë, duke e bërë librin gjithnjë e më interesant, dhe besoj se do t'i entuziazmojë të gjithë ata që do ta lexojnë.

Më prek veçanërisht zgjedhja që Hyji bëri për të që nga fëmijëria dhe mënyra se si zhvillohet tek ajo, njëkohësisht, dashuria për Jezu Krishtin dhe thirrja misionare.

Dua të përmend këtu në mënyrë të veçantë pjesën e parë të librit, sepse jam nga Tudela, dhe pikërisht aty Zoti i jep prekjen e parë të hirit të tij. Si shumë të zgjedhur të tjerë, Zoti e kishte shënuar që në fëmijëri. Ajo tregon se, kur shkonte në shkollë, hynte në katedrale, e cila është një perlë e arkitekturës romane të shekullit XII, dhe më prekte të kujtoja se pikërisht aty Carmen lutej çdo ditë gjatë fëmijërisë dhe adoleshencës së saj! Carmen shkruan: «Dhuratat që kam marrë në katedralen e Tudelës, askush nuk i njeh.»

Tudela është një qytet që i përket një rajoni në veri të Spanjës: Navarra. Navarra në të cilën jetoi Carmen ishte e mbushur me frymë misionare nën shtysën e figurës së Shën Françesk Ksavierit, mbrojtësit të misionëve, dhe gjatë shekullit XX ishte dioqeza me numrin më të madh të thirrjeve misionare. Në këtë klimë misionare kontribuoi shumë figura e Imzot Marcellino Olaechea-s, i cili ishte ipeshkëv i Navarrës kur Carmen jetonte në Tudela: ai jo vetëm që mbështeti themelimin e Villa Teresita dhe të Misionareve të Krishtit Jezus, por e bazoi të gjithë veprimtarinë e tij baritore mbi figurën e njeriut më të madh që kishte nxjerrë ndonjëherë Navarra: Shën Françesk Ksavieri, duke nxitur një frymë misionare në mbarë shoqërinë navarreze. Carmen e konsideronte Don Marcellino-n një shenjt dhe mbajti me të një marrëdhënie të ngushtë gjatë viteve që kaloi me Misionaret e Krishtit Jezus, kur ai ishte tashmë Arqipeshkëv i Valencias. Kjo klimë misionare e Navarrës e pasuroi dhe e ndihmoi këtë thirrje të Carmen-it.

Por, përtej kësaj atmosfere misionare të Navarrës, Carmen studioi edhe në Kolegjin e Shoqërisë së Marisë, ku jepej një formim shumë i mirë njerëzor dhe i krishterë. Nga themelimi origjinal i shekullit XVIII, ku Carmen studioi, sot ka mbetur vetëm kisha, një kapelë e çmuar baroke. Përballë saj ndodhet Kolegji i Shoqërisë së Jezusit, për të cilin Carmen na ka folur shumë herë dhe falë të cilit pati mundësinë të njihte shumë jezuitë, që ishin misionarë në Lindje dhe që do të shënjonin thirrjen e saj misionare. Një thirrje aq e fortë, sa që në adoleshencë do të përpiqej të paktën tri herë të shkonte në mision, por familja e saj do ta pengonte.

E tregoj gjithë këtë, që shpjegohet me hollësi në libër, sepse ishte pikërisht aty, në ato vitet e para të jetuara në Tudela, ku Zoti do t'i linte një vulë të pashlyeshme për Vetën dhe për misionin që do ta shoqëronte gjatë gjithë jetës. Edhe në

çastet e varfërisë së plotë dhe të vuajtjeve të mëdha, këto do të mbeteshin si dy shtylla të palëkundura të jetës së saj: dashuria për Jezu Krishtin dhe për misionin.

Kur tashmë e kupton se do të përjashtohet nga Instituti Misionar dhe sheh se projekti i saj i jetës, ai për të qenë misionare, po shembej, në pranverën e vitit 1962, i shkruan të atit: «E gjithë dashuria dhe kujdesi juaj nuk janë në gjendje ta mbushin këtë jetë, të cilën gjithmonë e kam ëndërruar vetëm për Hyjin. Po, është një martirizim i vërtetë të mos mendosh për asgjë tjetër veçse për Jezu Krishtin, mëngjes, mesditë e mbrëmje... Nuk kam pasur kurrë asnjë dyshim, që nga fëmijëria, për thirrjen time; a e kupton martirizimin tim?»

Gjatë kohës së Gjetsemanit të saj në Barcelonë, ajo arrin të pyesë veten nëse është normale të kesh këtë dëshirë për t'i përkatur plotësisht Zotit dhe shkruan në ditarin e saj: «Jezus, do të doja t'i pyesja etërit e mi shpirtërorë nëse të gjithë njerëzit, që kur janë të vegjël, e ndiejnë këtë përkatësi të plotë ndaj Teje, Jezus.»

Për këtë arsye nuk është për t'u habitur që disa prej atyre që e kanë lexuar Biografinë dhe nuk janë të Ecjes Neokatekumenale na kanë thënë: «Ajo është një nga figurat e mëdha të Kishës!»

Poeti më i madh hebre i Mesjetës, Yehuda-Ha-Levi, gjithashtu ka lindur në Tudela. Ai kaloi shumë vite duke ëndërruar të arrinte në Tokën e Premtuar dhe, në fund të jetës, ia doli, duke vdekur atje. Carmen mbërriti në Izrael kur ishte 33 vjeçe dhe gjurma e këtij shtegtimi do ta shënonte pjesën tjetër të jetës së saj. Një fjalë e famshme e Yehuda Ha-Levit thotë: «Zemra ime është në Lindje, ndërsa unë ndodhem në skajin më perëndimor.»

Ky mall dhe kjo dashuri për Tokën e Shenjtë do të ishte, ashtu si për poetin, një vazhdimësi në jetën e Carmen-it pas atij udhëtimi, gjë që do të pasqyrohej vazhdimisht në predikimin e saj dhe, nëpërmjet tij, do t'ua përcillte këtë dashuri për popullin e Izraelit vëllezërve të saj të Ecjes Neokatekumenale.

Po kaloj tani në fundin e librit. Është prekje të njohësh sa shumë ka vuajtur fizikisht Carmen gjatë viteve të fundit të jetës së saj dhe durimin me të cilin i përballoi sëmundjet.

Por ajo që më ka bërë vërtet përshtypje janë shtojcat, ku mund të shihet në mënyrë përmbledhëse veprimtaria e saj apostolike dhe udhëtimet e saja, të cilat janë aq të shumta sa mund të bëheshin objekt i disa librave. Plani i Zotit shkonte shumë përtej ëndrrës së saj për të qenë misionare. Ajo nuk do ta kishte imagjinuar kurrë sa herë, së bashku me Kiko-n dhe At Mario-n, do të përshkonte botën duke shpallur Ungjillin. Sa takime thirrjesh përpara mijëra të rinjve që e duartrokisnin dhe kërkonin një fjalë prej saj, plot parrezi, plot guxim në mes të kësaj bote pagane, si një profeteshë e vërtetë!

Për ta përfunduar, një të dhënë të fundit mbi Carmen-in: amësinë e saj. Ishte një grua shumë e zgjuar dhe me aftësi të mëdha pune; ishte një grua e urtë, e cila i vuri dhuntitë e saj në shërbim të katekumenëve të saj. Jetonte në një kërkim të vazhdueshëm për t'u transmetuar vëllezërve dhe motrave të Ecjes urtinë që vjen prej së larti, si një nënë që lodhet pa kursim për të siguruar ushqimin për fëmijët e saj. Më kujtohet se murgeshat e Kolegjit i quanim «nëna»; në të gjithë librin shihet edhe te Carmen kjo amësi karakteristike e grave të kushtuara. Një amësi që, si gjithçka tek ajo, e jetoi në thellësi dhe që e shtynte t'u fliste vajzave duke u nisur nga e vërteta, që të mos mashtroheshin nga ideologjia mbizotëruese. Shprehja e saj e famshme: «Gruaja ka fabrikën e jetës dhe, për këtë arsye, djalli e sulmon më shumë», ka ndihmuar shumë gra të jetojnë kundër rrymës, duke u bërë nëna të familjeve të mëdha. Por jo vetëm kaq; shumë vajza

kemi zbuluar thirrjen për ungjillëzim dhe për itinerancë, duke ndjekur gjurmët e Carmen-cit, dhe shumë e shumë të tjera për jetën rregulltare.

Formimi i saj shkencor, i bashkuar me ndjeshmërinë e saj femërore, i lejoi të sodiste Hyjin Trini në krijim, me një përzierje admirimi, adhurimi dhe ekstaze. Për këtë arsye më pëlqen ta përfundoj, meqë ajo i donte aq shumë Shkrimet e Shenjta, me një varg nga Libri i Danielit, i cili përmbushet në mënyrë të përkryer në jetën e saj:

«Dijetarët do të shkëlqejnë pors i kthjelltësia e kupës qiellore, e ata që ua kanë mësuar shumëve drejtësinë, do të shkëlqejnë pors i yjet në amshimin e përhershëm» (Dan 12,3).

D. EZECHIELE PASOTTI:

Faleminderit, Maria Ascensión. Përpara se t'ia lëmë vendin interpretimit të orkestrës, më duket e drejtë që, shumë shkurt, të shprehim tri falënderime që duhet t'i bëjmë: i pari, Kardinalit James Michael Harvey, Arqipriftit të Bazilikës Papnore të Shën Palit jashtë mureve, dhe bashkëpunëtorit të tij, doktor Vincenzo Coraggio, për ndjeshmërinë dhe bashkëpunimin që na kanë treguar, duke bërë të mundur këtë dhe takime të tjera këtu në Bazilikë, ku shpirti i Shën Palit e forcon shpirtin misionar të Ecjes Neokatekumene. Një duartrokitje.

Gjithashtu, edhe dy falënderime shumë të shkurtra për persona që tashmë janë përmendur, por më duket e rëndësishme t'i kujtojmë në fund të këtij takimi: një falënderim formatorëve, meshtarëve dhe seminaristëve të Seminarit Redemptoris Mater të Galileës për përkthimin në italisht, për të cilin janë kujdesur; dhe një falënderim edhe për Agnese Coghe-n dhe studion grafike Coart, Comunicare con Arte, nga Roma, për realizimin e mrekullueshëm grafik të 60 faqeve që ilustrojnë vëllimin dhe jetën e Carmen-it.

Dhe tani, Kiko ka përgatitur për këtë interpretim të simfonisë një paraqitje të shkurtër, të cilën ju ftoj ta dëgjoni. Është hera e parë që edhe unë i dëgjoj këto fjalë të Kiko-s, duke vendosur këtë lidhje ndërmjet simfonisë dhe jetës së Carmen-it; janë vërtet të bukura. Ju ftoj t'i dëgjoni dhe më pas do t'ia lëmë vendin orkestrës.

KIKO ARGÜELLO:

Atëherë, do të donim ta përfundonim këtë akt me një dëgjim të shkurtër muzikor mbi vuajtjen e të pafajshmëve, frymëzuar nga vuajtja e Zojës. Nuk di ta shpjegoj se si Hyji më frymëzoi këtë homazh për Virgjërën Mari. Gjatë gjithë jetës sime kam mbetur thellësisht i prekur nga vuajtja e të pafajshmëve dhe mendova të shkruaj një poemë simfonike kushtuar vuajtjes së Virgjërës Mari. Por gjëja më e rëndësishme është se Hyji deshi që Virgjëra Mari ta merrte mbi vete shpatën e shpallur nga profeti Ezekiel për shpëtimin tonë; e bëri bashkëshëlbuese me Birin e saj.

Frymëzimi që pata gjatë kompozimit të kësaj simfonie ishte se shpata e tmerrshme, e profetizuar nga Ezekieli (krh. Ez 21), e përgatitur për mua, që jam mëkatar, dhe për ty, të shponte shpirtin e kësaj gruaje hebreje, Virgjërës Mari, në mënyrë që vuajtja e saj të bashkohej me Shëlbimin universal të Zotit tonë Jezu Krisht: Ai e ka shenjtëruar vuajtjen njerëzore, prandaj ne duhet të gjunjëzohemi përballë vuajtjes së të pafajshmëve.

Në barakat, Carmen-i dhe unë kemi jetuar mes njerëzve të shkatërruar, viktima të mëkatit të shoqërisë. Kemi ndeshur një vuajtje njerëzore të padëgjuar dhe misterin e Krishtit të kryqëzuar. Kemi kuptuar se ekziston një prani e Krishtit tek ata që vuajnë, veçanërisht në vuajtjen e të pafajshmëve. Njerëz të pafajshëm që mbanin mbi vete mëkatin e të tjerëve: incestin, dhunën, drogën, alkoolin... Dikush kishte parë të vritej babai i tij, një tjetër ishte dhunuar... Këta të pafajshëm po mbanin, së bashku me Krishtin, shpëtimin e botës. Hyji deshi që pikërisht në atë mjedis – mes ciganësh, hajdutësh, prostitutash, të droguarish... – Carmen-i dhe unë të takoheshim. Vërtet e madhe ishte prania e Jezu Krishtit, e Shpirtit Shenjtë, mes atyre të varfërve që e pranonin Fjalën e Hyjit.

Kam mbetur i tronditur përballë Krishtit, të vdekur në kryq, i pranishëm në jetën e shumë prej tyre. Çfarë misteri është vuajtja e kaq shumë të pafajshmëve që mbajnë mbi vete vuajtjen e të tjerëve! Hyji u bë njeri për ta marrë mbi vete vuajtjen e të gjithë të pafajshmëve. Ai është i Pafajshmi i plotë, Qengji i çuar në therje që nuk hap gojën, Ai që mban mbi vete mëkatet e të gjithëve.

Në këtë vepër të vogël paraqitet Virgjëra Mari e nënshtuar ndaj skandalit të vuajtjes së të pafajshmëve në mishin e saj, në mishin e Birit të saj. «Ah, ç’dhimbje!», këndon një zë ndërsa një shpatë i shpon shpirtin. Do të donim të kremtonim së bashku, me këto skica të shkurtra muzikore, çastin kur një engjëll e mbështet Virgjërën, ashtu siç ndodh me Jezusin në Malin e Ullinjve, kur një engjëll e ndihmoi të pinte kelkun e përgatitur për mëkatarët.

Do të donim të sodisnim dhe të mbështesnim Virgjërën, e cila e pranon atë shpatë që, sipas profetit Ezekiel, Hyji e kishte përgatitur për mëkatet e popullit të tij dhe që tani përshkon shpirtin e kësaj gruaje të varfër, Marisë, Nënës së Hyjit. E Shenjta Theotòkos. Guxim! Ti je Nëna e atij Hyji që bëhet mëkat për ne dhe e ofron veten për shpëtimin e të gjithëve. Nëna e Hyjit dhe Nëna jonë!

Orkestra do ta interpretojë sot këtë simfoni si homazh për Carmen-in, e cila e donte shumë Virgjërën Mari. Në ditarët e saj ajo shfaqet gjithmonë si ngushëllim dhe, edhe në çastet e vuajtjes më të madhe, Carmen-i nuk pushoi kurrë së thirruri: «Virgjëra Mari tejet e ëmbël».

Simfonia ka pesë kohë, të cilat na fusin në Misterin Pashkvor: nga Gjetsemani deri në Ringjallje. Që Carmen-i të mund t’i sillte Ecjes ripërtëritjen pashkvore të Koncili II i Vatikanit, Hyji e bëri ta jetonte në mënyrë ekzistenciale Misterin Pashkvor të vdekjes dhe të ringjalljes. Në Barcelonë, kur nuk iu lejua të vazhdonte në Institutin Misionar, në kulmin e *kenosis* (zbritjes) së saj, Hyji i dërgoi një engjëll në Gjetsemanin e saj: At Farnés-in. Kështu ajo do ta jetonte Pashkën si një dinamikë në mishin e saj. Zoti do ta udhëhiqte që të përjetonte ringjalljen dhe lartësimin.

Koha e parë që do të dëgjoni quhet «Gjetsemani»; është si një përshkrim muzikor i ankthit të Zotit tonë Jezu Krisht. Nëse mendoni për Jezu Krishtin në Kopshtin e Ullinjve, muzika do t’ju duket krejt ndryshe. Vjen një çast kur Jezu Krishti nuk mundet më dhe i thotë Atit të tij: «Nëse është e mundur, largoje prej meje këtë kelk; megjithatë, u bëftë jo vullneti im, por vullneti yt». Pikërisht në atë çast Hyji i dërgon një engjëll. Për të treguar engjëllin që vjen ta ngushëllojë, violinistët do të ngrihen në këmbë. Më pas do të dëgjoni një daulle që shpall ardhjen e Judës me ushtarët për ta arrestuar Jezu Krishtin. Dhe në fund kori do të këndojë: «Abba, Abba, Atë», duke treguar se Krishti ka fituar, sepse ka bërë vullnetin e Hyjit.

Koha e dytë quhet «Vajtim». Ndërrojmë skenën dhe shohim Virgjërën në këmbë nën kryqin e Birit të saj, duke përjetuar një dhimbje të heshtur, të tmerrshme: do të dëgjoni harpën që përfaqëson lotët e Virgjërës. Është një vajtim në nder të vuajtjes së Virgjërës përballë tmerrit të shikimit të Birit të saj të kryqëzuar.

Në kohën e tretë shohim Krishtin në kryq, i cili thërret: «Atë, fali ata!». Në mes të korit, një tenor do të bërtasë: «Fali ata!».

Koha e katërt është «Shpata»: Virgjëra që është gati të shpohet nga ndëshkimi që duhej ta merrnim ne. Ashtu si Ezeieli, në një tjetër pjesë, flet për kelkun e hidhërimit që Hyji do t’ia japë popullit për mëkatet e tij, ai kelk do të pihet nga Krishti, i cili do ta bashkojë me shpatën edhe Nënë e tij në Shëlbimin universal. I gjithë kori do të këndojë: «Shpatë, shpatë e lëmuar për të vlarë», dhe një zë fëmije do të këndojë: «Oh, ç’dhimbje!», kur shpata i shpon shpirtin. Dhe në atë çast – që është kulmi i këtij takimi tonë – do t’ju kërkoj të gjithëve të vendosemi me Virgjërën Mari nën kryq, duke mbështetur dhimbjen e saj të tmerrshme. Sepse askush prej jush nuk mund ta imagjinojë se çfarë do të thotë të kesh shpirtin e shpuar; askush prej jush nuk e ka përjetuar atë dhimbje të tmerrshme dhe as nuk e di se çfarë mund të nënkuptojë. Do të ngrihem i gjithë në këmbë dhe do të këndojmë së bashku me korin: «Mari, Nëna e Hyjit!», sikur t’i thoshim Virgjërës: Guxim, sepse Hyji të ka bërë pjesëmarrëse në Shëlbimin universal. Në një moment dirigjenti do të kthehet nga ne dhe të gjithë do të këndojmë së bashku me korin: «Mari, Nëna e Hyjit».

Do ta përfundojmë duke kënduar «Resurrexit».

D. EZECHIELE PASOTTI:

Mirë, dhe tani fjalën e ka kori, i drejtuar nga profesori i nderuar Tomasz Hanus.

KIKO ARGÜELLO:

Ku është Tomasz Hanus? Mirë, le të dëgjojmë orkestrën poshtë. Guxim, djem, guxim! Zoti është ringjallur.

Eksekutimi i simfonisë «Vuajtja e të pafajshmëve» — Orkestra e Ecjes Neokatekumenale, e drejtuar nga profesori i nderuar Tomasz Hanus

KIKO ARGÜELLO (në përfundim të interpretimit):

ARTI, BUKURIA dhe DASHURIA. Me lejen tuaj, dua ta falënderoj Zotin.

Zot, të falënderojmë për këtë takim, për praninë tënde, për dashurinë tënde ndaj artit, të cilin na e dhuron që ne të të japim lavdi Ty. Na jep hirin të të falënderojmë gjithmonë dhe të të duam, nëpër Krishtin Zotin tonë. Amen.

Ta falënderojmë Zotin për Carmen-in. Një duartrokitje për Carmen-in.

Bekimi i Kardinal Sarah

KIKO ARGÜELLO:

Gëzuar Krishtlindjen të gjithëve! Lutuni për ne: për Kiko-n, Carmen-in, Maria Ascensión dhe At Mario-n. Guxim, vëllezër! Gëzuar Krishtlindjen të gjithëve!

Paraqitja e librit: «Carmen Hernández. Shënime biografike». Transmetuar on-line në mbarë botën.